



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 17 datë 31.3.2022

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.3.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar;ligjit 75//2019 “Për Rininë”;ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; udhëzimit nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” ; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017; Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016; Marrëveshja e bashkëpunimit për zbatimin e Projektit FARO, ndërmjet Bashkisë Dimitrovgrad dhe Bashkisë Shkodër, me Nr. 3758 Prot, datë 21.02.2022; Rregullorja e Këshillit European (BE) Nr. 390/2014, prill 2014 që themelon programin “Europa për Qytetarët” për periudhën 2014 – 2020; Udhëzuesi i Programit “Europa për Qytetarët” (Versioni i vlefshëm që nga janari 2017); Thirtja për propozim: EACEA 36/2018: Rrjetëzimi i qytezave; VKB nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “FARO – Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një rrëfimi të identiteteve europiane të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve” financuar nga Programi “Europa për Qytetarët”. Kjo shtesë plani do të përfshihet në Buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” me aktivitetin P10430.O6.A3 sipas fishes bashkëlidhur, shuma 1,766,000 Lekë.

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2022	1,374,000			1,374,000		
Shuma 2023	392,000			392,000		
Shuma totale e Projektit e financuar nga programi	1,766,000			1,766,000		

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Llesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 1.4.2022